


# Eja, Më Ndiq – Veprimtaritë

Për mbrëmjen e shtëpisë ose studimin e shkrimeve të shenjta – ose thjesht për argëtim!



26 Gusht – 1 Shtator

## Themele të Forta

PËR KAPITUJT TE HELAMANI 1-6

Helamani u mësoi bijve të vet që ta ndërtonin jetën e tyre mbi themelin e fortë të Jezu Krishtit (shih te Helamani 5:12). Një themel është një vend mbi të cilin ndërtohet diçka. Një themel i fortë e bën të gjithë ndërtesën të fortë, edhe nga stuhitë. Ndërto dy kulla, njëren mbi një themel të fortë dhe tjetrën mbi një themel të dobët. Cila kullë është më e qëndrueshme? Si mund ta ndërtojme jetën tonë mbi Jezu Krishtin?

**Për fëmijët më të vegjël:** Ndhimjoni të vegjlit tuaj të gjejnë diçka që mendojnë se është vërtet e fortë. Çfarë gjetën ata? Jepni mësim se ne mund të jemi të fortë me Jezu Krishtin.



2-8 Shtator

## Dëshmia për Krishtin

PËR KAPITUJT TE HELAMANI 7-12

Shumë njerëz në shkrimet e shenjta dhanë mësim dhe dëshmuar për Jezu Krishtin (shih te Helamani 8:16-20). Edhe ti mund të fillosh ta ndërtosh dëshminë tënde për Të! Një dëshmi është diçka që e beson ose di se është e vërtetë rreth Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit. Shkruaje dëshminë tënde dhe ushtrohu që t'ia tregosh familjes apo shokëve e shoqeve të tua.

**Për fëmijët më të vegjël:** Pyetini të vegjlit tuaj se çfarë u pëlqen shumë rreth Jezu Krishtit. Më pas jepuni atyre dëshminë tuaj për Shpëtimtarin.



9-15 Shtator

## Samueli Ngjitet mbi Mur

PËR KAPITUJT TE HELAMANI 13-16

Samueli ishte një profet i cili dha mësim rreth Jezu Krishtit në majë të murit të një ayteti (shih te Helamani 13:4). Shko te faqja 12 dhe bëj punëdoren për të të ndihmuar që të tregosh historinë e Samuelit.

**Për fëmijët më të vegjël:** Mbajini të vegjlit tuaj ndërkohë që qëndrojnë mbi karrige dhe tregojnë atë që dinë rreth Jezu Krishtit, ashtu si bëri Samueli.

ILLUSTRIMET NGA KATY DOORILL

16-22 Shtator

## Loja e Mbledhjes

PËR KAPITUJT TEK 3 NEFI 1-7

Jezu Krishti premtoi se Ai do t'i mbledhte të gjithë fëmijët e Tij ngaqë Ai e do çdo njeri dhe dëshiron që njerëzit ta kenë ungjillin (shih tek 3 Nefi 5:24). Luaj një lojë me mbledhje. Bëji lojtarët të qëndrojnë në një rreth. Një person në mes thotë një fakt rreth vetes, si ngjyra e vet e parapëlqyer. Nëse ai fakt është i vërtetë për ndonjë person tjetër, edhe ai ose ajo do të vijë në mes. Vazhdo në këtë mënyrë derisa që të gjithë të mbledhen në mes.

**Për fëmijët më të vegjël:**

Luani hapa-dollapa me të vegjlit tuaj. Përqafojini fort kur t'i gjeni. Flisni rreth mënyrës se si Jezu Krishti premton se Ai do të na mbledhë pavarësisht nga vendi ku jemi.



23-29 Shtator

## Jezusi Është Drita

PËR KAPITUJT TEK 3 NEFI 8-11

Jezu Krishti është "drita dhe jeta e botës" (3 Nefi 9:18). Shiko një lindje ose perëndim të diellit me familjen tënde. Pastaj vizato një figurë të asaj që pe. Teksa vizaton, fol për arsyet përse e do Jezu Krishtin dhe se si Ai të sjell dritë.

**Për fëmijët më të vegjël:** Dilni jashtë dhe shikoni drita të ndryshme, si dielli, yjet ose hëna. Pyetini të vegjlit tuaj se si i bën të ndihen drita. Flisni për mënyrën se si Jezu Krishti është drita jonë.

